



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



## **DREJTORIA E BUJQËSISË**

### **THIRRJE PËR APLIKIM**

**Thirrje për aplikim për ngritjen e fermave të pulave, me sistem të lirë në natyrë, për prodhimin e mishit dhe vezëve natyrale**

#### **Kriteret e përcaktuara:**

- Aplikuesi duhet ta ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës, në sipërfaqe nga 0.20 ha – 1.0 Ha, dhe të jetë banorë i komunës së Prishtinës;
- Participimi i Komunës dhe fermerit do të jetë në raport: 80% Komuna dhe 20 % fermeri përfitues;
- Përkrahen fermerët fillestarë;
- Fleta poseduese dhe dëshmia mbi tatimin në pronë;
- Përparësi do të kenë fermerët në zonat rurale;
- Përparësi do të kenë fermerët, të cilët posedojnë pula në sistem të lirë;
- Përparësi do të kenë fermerët, të cilët nuk kanë përfituar në 3 (tri) vitet e fundit në projekte të ngjashme nga Komuna dhe donatorët në bashkëpunim me Komunën;
- Projektpropozimi për ngritjen e fermës në natyrë të lirë;
- Fermeri për çdo blerje të tij në ngritjen e kësaj ferme, duhet ta dëshmojë përmes transaksionit bankar;
- Rimbursimi i mjeteve financiare do të bëhet pasi organi përkatës konstaton realizimin e projektit nga ana e fermerit përfitues;
- Përfituesi obligohet që para fillimit të investimeve, t'i dorëzojë 3 oferta rreth koston për finalizimin e projektit;
- Pas sjelljes së ofertave, përfituesi do të njoftohet rreth vlerës financiare që do të përkrahet nga ana e Komunës.

### **Kriteret specifike:**

- Përkrahen fermerët në ngritje e fermave të pulave, me sistem të lirë në natyrë, për prodhimin e mishit dhe vezëve natyrale;
- Me projekt do të përkrahet rrethoja për parcelën për te cilën aplikohet;
- Përkrahet ndërtimi i koteceve për pula (objekt montazh);
- Përkrahja do të jetë deri në 500 copë pula;
- Vlera e përkrahjes do të jetë nga 2,000.00 euro deri në 7,000.00 euro për sipërfaqe të caktuar.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Kopja e një dokumenti identifikues i Republikës së Kosovës;
- Certifikata mbi pronësinë e tokës, jo më e vjetër se një vit;
- Kopja e planit, jo më e vjetër se një vit;
- Dëshmi mbi tatimin në pronë;
- Konfirmimi për llogarinë bankare;
- Dëshmi për numrin dhe origjinën e pulave (faturën);
- Projektpropozim për ngritjen e fermës në natyrë të lirë:
  - përshkrimi i gjendjes në fermë,
  - qëllimi i investimit,
  - kosto e investimeve;

Pasqyra mbi transferin bankar.

**Data e aplikimit: 31.10.2019 – 14.11.2019**